




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË



Korçë, më 14.02.2024

SHPLLJE VENDIMI

Drejtuar : Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq

Për shtetasin/en: Crescenozo Rispo
Me adresë: Drithas, Bashkia Maliq

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 814 dt. 24.10.2023 për t'u afishuar nga ana juaj njoftimi me shpallje me afat 20 ditor, pasi dëftesa e komunikimit është kthyer me shënimin : " larguar " dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geraldina Kasuli

U afishua sot në datë -----
Për Njësinë Administrative/Bashkinë

(emër, mbiemër, firmë)

- Nj. A. Shaban
- STIRP ✓
dt. 21.02.2024

Nr. 43 Prot

Paditësja Egla Malollari ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë kërkesë padinë me objekt zgjidhjen e martesës ligjore, mbështetur në nenin 132 e vijues të Kodit të Familjes.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje referuar neneve 41 dhe 349 germa "a" të K.Pr.Civile.

Po ashtu kjo gjykatë ka kompetencën tokësore referuar nenit 51 të K.Pr.Civile, pasi është gjykata e vendit ku bashkeshortët kanë lidhur martesën, si dhe ku kanë pasur banimin e tyre të përbashkët të fundit, meqë i padituri është shtetas italian dhe me banim zyrtar në Itali.

Në seancën e pajtimit të datës 24.10.2023, të zhvilluar në prani të paditëses dhe në mungesë të të paditurit, gjykata arriti në përfundimin se pajtimi mes bashkeshortëve dhe rikthimi në bashkëjetesë i tyre ishte i pamundur. Për këtë arsye, Gjykata vendosi vazhdimin e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi e provuar se paditësja Egla Malollari ka lidhur martesën ligjore me të paditurin Crescenzo Rispo në datë 27.08.2013, referuar certifikatës së martesës të lëshuar në datë 15.04.2022 nga Zyra e Gjendjes Civile Njesia Administrative Libonik. I padituri është shtetas i huaj (italian) dhe martesë është lidhur në zyrën shqiptare të gjendjes civile Njesia Administrative Libonik (ku ka qene vendbanimi i paditëses). Nga kjo martesë palët nuk kanë fëmijë.

Paditësja Egla Malollari dhe përfaqësuesi i saj gjatë gjykimit deklaruan se me të paditurin kanë lidhur martesë ligjore në vitin 2013. Fillimisht ka ardhur i padituri në Shqipëri e me pas janë larguar në Itali. Marrëdhëniet me të paditurin kanë pasur problematika, për shkak edhe të menyrës së jetesës, me të cilën paditësja nuk mund të përshatej. Përveç kësaj, paditësja ka pretenduar se i padituri ushtronte edhe dhunë fizike ndaj saj, gjë që e ka bërë gjendjen të padurueshme dhe e ka detyruar paditësen të largohet dhe të kthehet në Shqipëri tek prinderit.

Sipas paditëses, ata kanë rreth 6 vjet që janë veçuar, dhe prej asaj kohe nuk kanë pasur asnjë lidhje apo kontakt me të. Paditësja e ka kontaktuar në rrjetet sociale për t'i kërkuar ndarjen, gjë për të cilën i padituri i ka deklaruar se nuk ishte dakord.

Në të tilla kushte paditësja deklaroi se martesë e ka humbur qëllimin dhe kuptimin për të cilën është lidhur, ajo nuk shikon asnjë mundësi për fillimin e bashkëjetesës me të paditurin, ndaj dhe kërkon zgjidhjen e kësaj martesë.

I padituri Crescenzo Rispo nuk u paraqiti në asnjë seancë gjyqësore për të parashtruar pretendimet e tij rreth kërkesëpadisë.

Duke qene shtetas i huaj, njoftimi i tij u bë me leterporosi sipas parashikimeve të nenit 135, 219 të K.Pr.Civile si dhe Konventës mbi Njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumentave gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare, duke i dërguar njoftimin dhe aktet përmes Ministrisë së Drejtësisë si Autoriteti Qendror i përcaktuar në Konventë për këtë procedurë njoftimi.

Sipas akteve të Autoriteteve Italiane të Drejtësisë, percjelle në gjykate me shkresën nr.750/5 Prot. K.P, datë 27.07.2023 të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, formulari përkatës dhe aktet e tjera i janë njoftuar të paditurit Crescenzo Rispo në adresën e shënuar në këto akte.

Pavaresisht dijenise, i padituri nuk u paraqit ne gjykim, ndaj në të tilla rrethana, gjykata bazuar në nenin 135/2 të K.Familjes dhe 179 te K.Pr.Civile, vijoi gjykimin në mungesë të të paditurit.

Gjykata mban parasysh kriteret e nenit 132 të Kodit të Familjes në të cilin përcaktohet se *“Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur për shkak të grindjeve të vazhdueshme, keqtrajtimeve ... jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesa ka humbur qellimin e saj”*.

Mbështetur në përcaktimet e mësipërme, çdo njërit prej bashkëshortëve i lind e drejta të kerkoje zgjidhjen e martesës dhe nje nga shkaqet per te cilin secili bashkeshort mund te kerkoje zgjidhjen e martesës janë mosmarreveshjet midis tyre te cilat per shkak te karakterit te tyre te vazhdueshem e kane bere jetesen e perbashket midis bashkeshortëve te pamundur dhe martesa e ka humbur qellimin e saj ne funksion te mireqenies materiale dhe emocionale te bashkeshortëve.

Pra, gjykata duke vlerësuar pohimet e palës paditese dhe provat e administruara në seancë gjyqësore konstaton faktin së grindjet e vazhdueshme dhe mosmarreveshjet ndërmjet palëve, kanë sjellë si pasojë mosfunksionimin e martesës ligjore që duhet të karakterizojë një marrëdhënie martesore normale. Duhet theksuar fakti se të dy bashkëshortët prej shumë vitesh (afro 63 vjet) kanë shkëputur çdo lidhje e komunikim midis tyre, duke i dhënë në këtë mënyrë faktikisht fund lidhjes të tyre.

Nisur nga sa u parashtrua më sipër, gjykata vlerëson se duhet të vendosë zgjidhjen e martesës ligjore midis paditëses Eglja Malollari dhe të paditurit Crescenzo Rispo.

Në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës, gjykata ka detyrim të shprehet në lidhje me këto pasoja midis bashkëshortëve, duke marrë parasysh kriteret e nenit 146 të Kodit të Familjes, në të cilin përcaktohet se *“Bashkeshorti qe me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes se martesës merr mbiemrin qe ka pasur perpara lidhjes se martesës. Gjykata, me kerkesen e njerit bashkeshort dhe kur eshte ne interes te tij ose te femijeve, mund te lejoje qe ai te mbaje mbiemrin qe ka marre me lidhjen e martesës”*.

Ne rastin konkret, nuk rezulton qe ndonje nga palet te kete ndryshuar mbiemrin me rastin e martesës, por secili prej tyre ka mbajtur mbiemrin e tij, per rrjedhim nuk ka vend per ndonje rregullim referuar kesaj dispozite.

Po ashtu, duke mbajtur parasysh nenin 143 te Kodit te Familjes dhe nenin 31 te Ligjit nr. 10129 “Per Gjendjen Civile”, gjykata ka detyrimin që brenda 15 diteve nga dita qe vendimi merr formë të prerë të dërgojë për regjistrim një kopje të tij ne Zyren e Gjendjes Civile përkatëse, ne rastin ne gjykim ne Zyren e Gjendjes Civile Njesia Administrative Libonik.

Përsa i perket shpenzimeve gjyqësore, ato përbehen nga taksa mbi aktet e padisë në shumën 3.000 leke të parapaguara nga paditësja, si dhe shpenzimet qe ajo mund te kete kryer per perfaqesimin me avokat por qe nuk u evidentuan gjate gjykimit. Në mbështetje të nenit 102 dhe 106 të Kodit të Procedures Civile, gjykata çmon që këto shpenzime të mbetën në ngarkim të paditëses sikurse janë bërë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
K O R Ç Ë

Nr.Regj. 21001-01479-41-2022 (588/1324)
Datë regjistrimi 11.10.2022

Nr. Vendimi 41-2023-3232 (814)
Datë Vendimi 24.10.2023

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, e përbërë prej:

Gjyqtare Luljeta KOLE

Asistuar nga sekretare Janulla Tanka, në Korçë, në datë 24.10.2023, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile që i përket:

PADITËSE: Eglja Malollari, e bija e Xhezmi dhe Lefterije, e datëlindjes 04.08.1989, lindur në Velçan, Korçë dhe banuese në Libonik, Bashkia Maliq, e martuar, pa fëmijë, përfaqësuar nga avokat Hysni Xhelollari, anëtar i Dhomës së Avokatisë Korçë në bazë të autorizimit noterial datë 30.09.2022 lëshuar pranë noterit publik në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe me deklaram të vetë paditëses në seancë gjyqësore.

I PADITUR: Crescenzo Rispo, i biri i Giuseppe dhe Giovanna, i datëlindjes 17.06.1980, shtetas italian, lindur në Villaricca dhe banues në adresën: Via Bellinzova 90, Modena, Itali, gjykuar në mungesë.

OBJEKTI: Zgjidhje martese

Baza ligjore: Neni 132, 146 i Kodit të Familjes.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të paditëses dhe përfaqësuesit të saj, si dhe në mungesë të të paditurit, është kërkuar:

Paditësja: Zgjidhjen e martesës, marrjen e mbiemrit te vajzerise
I padituri: Në mungesë.

Gjykata pasi shqyrtoi aktet dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

PËR KËTO ARSYE


Gjykata, bazuar ne nenin 132 te Kodit te Familjes dhe
Nenet 126 e 306-310 te K.Pr.Civile

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesëpadisë.
2. Zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur në datë 27.08.2013 midis paditëses Egla Malollari dhe të paditurit Crescenzo Rispo.
3. Një kopje e këtij vendimi të dërgohet në Zyrën e Gjendjes Civile Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq, pas marrjes formë të prerë.
4. Shpenzimet gjyqësore në masën 3000 lekë mbeten në ngarkim të paditëses sikurse janë bërë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 15 ditëve nga e nesërmbja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Korçë, sot në datë 24.10.2023 ora 14:24

SEKRËTARE
JANULLA TANKA



GJYQTARE
LULJETA KOLE

